

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Burrel”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

32428000-9 - Upgrade rrjeti.

VLERA E FONDIT LIMIT:

35,000,000 (tridhjetë pesë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros per vitin e fundit financiar te jete ne masen paktën 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 14,000,000 (katërmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të

kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shenim: Kontrata të ngjashme do të konsiderohen furnizimet dhe shërbimet në lidhje me to, të realizuara në Nënstacionet elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë 40 % të vlerës së fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përsa i përket cilësisë së kontratave të ngjashme, sipas opinionit teknik të inxhinierëve të AK gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, sqarojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. administron rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me tension 110-400 kV, që përbëhet nga nënstationet 400/220 kV, nënstatione 110/TM kV dhe linjat 110/220/400 kV.

Për të garantuar funksionimin normal dhe të sigurtë të sistemit elektro-energjetik, OST sh.a. ka përdorur zhvillimin, automatizimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen e komponentëve të Sistemit të Transmetimit.

Theksojmë se, OST sh.a. është institucioni i vetëm menaxhues i objekteve me këto nivele tensioni.

Garantimi i qëndrueshmërisë së Sistemit Energjetik si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike në tensionet e larta bazohet në zbatimin e rreptë të rregullores së Sigurimit Teknik dhe të Shfrytëzimit Teknik të Nënstationeve dhe Linjave të Sistemit Energjetik.

Për të bërë një krahasim të nivelit teknik/profesional të kërkuar në punimet në pajisjet e tensionit të lartë argumentojmë si vijon për punimet me nivel tension 110 kV:

- Rrjetet 110 kV, administruar nga OST sh.a. janë të ndërtuar në ajër (AIS) pra, përdorin qëndrueshmërinë elektrike të ajrit si material izolues. Ato kërkojnë sipërfaqe të mëdha dhe në shumë raste punime në hapësira që janë afër pajisjeve nën tension të lartë që paraqesin

rrezikshmëri të lartë për operatorët. Puna e tyre mbikëqyret dhe kushtëzohet nga kërkesat e rregulloreve të sipërpërmendura. Në nënstacion/linja mund të punojnë vetëm operatorë të instruktuar dhe me kartelë të sigurimit teknik.

- Pajisjet primare vendosen në bazamente betoni të armuar dhe konstruksione mekanike të veçanta. Theksojmë që pajisjet primare janë të rënda dhe njëkohësisht tepër delikate. Ato kërkojnë makina ngritese/transportuese si dhe rrespektimin e rregullave të veçanta për transportin, lëvizjen, vendosjen në bazament dhe montimin.
- Punimet për kabllimin, testimin, komisionimin e tyre, të cilat kryhen për secilin element kanë nevojë për operatorë shumë të specializuar për shkak të vështirësive, kompleksitetit të punimeve dhe kanë një kosto relativisht të madhe.
- Mbrojtja rele është një pajisje komplekse që shfrytëzon të dhëna të kombinuara (rryme/tension) dhe mbrojtje rryme, të cilat kablohen duke krijuar llogjika për bllokime elektrike për mosveprim në rast veprimesh të gabuara. Mbrojtjet rele dhe automatika (BCU) vendosen në panele të veçanta.
- Për testimin dhe komisionimin e saj ndiqet një procedurë e standardizuar IEC. Kompleksiteti i punës në to kërkon gjithashtu punonjës me specializim të lartë dhe njohuri të thella për pajisjet.
- Matja vendoset në panele të veçantë dhe ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të rrepta IEC. Operatorët janë tepër të specializuar.
- Në një nënstacion bëhen punime për SKADEN dhe Telekomunikacionin që kërkojnë njohje të pajisjeve dhe specializim të lartë të operatorëve dhe kompanive që punojnë.
- Punimet për ndërtimin/rikonstruksionin/punimet e linjave të tensionit të lartë kanë vështirësi që lidhen me projektimin, ndërtimin, vendosjen e shtyllave, përcjellësve dhe elementeve të ndryshëm përbërës të saj. Ndërtimi i një linje të tensionit të lartë kërkon makina dhe pajisje speciale pa të cilat kompromentohet seriozisht cilësia e punimeve për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i linjave të tensionit të lartë kërkon kushte teknike të veçanta dhe shumë të rrepta pasi ato ju nënshtrohen kushteve atmosferike tepër të rënda dhe duhet të paraqesin qëndrueshmëri të mjaftueshme mekanike ndaj tyre.
- Mund të pohojmë se, kompleksiteti, vështirësia dhe rëndësia e punimeve të sipërpërmendura rritet me rritjen e nivelit të tensionit (ndryshimi mes 110 kV dhe niveleve të tjera më të ulëta të tensionit) dhe përcakton në mënyrë domethënëse edhe kërkesat për nivelin profesional të operatorëve që do të kryejnë ato si dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve.

Theksojmë se: në përcaktimin e kushteve për punime në objektet e OST sh.a., përveç rregulloreve tona, është marrë si model edhe procedura dhe kërkesat teknike të ndjekura nga Kontraktorë të huaj shumë të njohur dhe me eksperiencë që kanë punuar në objektet tona prej më shumë se 15 vite.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesit ose distributorit te autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit te autorizuar duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme ISO, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituar nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilesise, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*
- *ISO 27001: për Sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*
- *ISO 20000-1: për Sistemin e menaxhimit të shërbimit.*

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata për menaxhimin e cilesise ISO 9001: është referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit te sigurise se informacionit ISO 27001: është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit, për shkak te rëndesise se veçante që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht ne sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Certifikimi sipas kesaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurine e

nevojshme AK. Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria. Menaxhimi i shërbimit IT siguron qe operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shërbimit ISO 20000-1: garanton se ofruesi i shërbimit objekt prokurimi është i certifikuar për të planifikuar, krijuar, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar një shërbim. Kërkesat përfshijnë projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e dakorduara të shërbimit, nepermjet sigurise se nevojshme per ecurine e punes se AK.

Kërkesa në lidhje me këtë certifikatë është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, duhet të ketë punonjes të certifikuar, si më poshtë:*

- ✓ *Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per Menaxhim Projekti.*
- ✓ *Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si Ethical Hacker (CEH ose ekuivalent).*
- ✓ *Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne implementimin dhe menaxhimin e sistemeve te sigurise se informacionit (CISM ose ekuivalent).*
- ✓ *Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar ne rrjeta kompjuterike CCNA ose ekuivalent.*
- ✓ *Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si Manager i Sistemeve IT (ITIL ose ekuivalent).*
- ✓ *Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar menaxhimin e sigurise dhe riskut ne sistemet e sigurise.*

Punonjesit e certifikuar si me siper, duhet te jete te diplomuar ne Shkenca Elektronike / Teknologji Informacioni / Informatike / Informatike Ekonomike / Telekomunikacioni.

Shenim: *Nje punonjes mund te zoteroje me shume se nje certifikim te kerkuar si me siper.*

Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, per te gjithë stafin e kerkuar me siper, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: CV-të, listepagesat e-Sig per periudhen 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, diplomat apo certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për punonjesit e sipërpërmendur është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e tij tregtar këtë veprimtari. Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me Nenin 40, pika 5/c, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit (te perkthyer dhe noterizuar) për mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se: Mallrat objekt procedure prokurimi janë të reja dhe të pa përdorura me parë.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë saktësisht kolonen me të dhënat teknike të ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura në Shtojcën 5 (Specifikimet teknike) të ketyre DT-ve, ku kërkohe.

Mosplotësimi i sakte është element skualifikimi.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara.

Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njih konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.8 *Ne funksion të plotesimit të Shtojces 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Ates, Amesi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratores të shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.